

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Lokale: Izdaje: Data: Dana 05.08.2025		
Nr. Orgv. 01	Nr. Prot. 74	Nr. Fqeve. 1
Org. jed.	Br. Prot.	Br. Strana.
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.74
Data: 31.07.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt me Nr.01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR PEZULLIMIN E VENDIMEVE 48,49,50,51,52,53,56 TË DATËS 30.05.2025 SI DHE ANULIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.55 TË DATËS 30.05.2025.

I

Vendimet: 48,49,50,51,52,53,56 të datës 30.05.2025 Pezullohen deri në krijimin e kushteve ligjore për procesim të mëtutjeshme të procedurave të këmbimit ashtu si e parasheh Ligji me Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, paragrafi 5 i nenit 29 i Rregullorës (QRK) NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa Vendimi me Nr. 01.Nr.55 i datës 30.05.2025 anulohet pasi pala ka tërhequr kërkesën për këmbim.

II

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Ferizajt.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
BREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izlaze: Data / Data 05.08.2025		
Nr. Orgv Org. jed 01	Nr. Prot Br. Prot 75	Nr. Fajqeve, Br. Strana 1



Ferizaj
 REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.75
 Data: 31.07.2025

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 25 paragrafi 2, pika 2.9, neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt me datë 31.07.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR SHKËPUTIJEN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME AGJENSINË
 PËR ZHVILLIM RAJONAL-LINDJE “AZHR” TË DATËS 16.12.2008, NË MES
 KOMUNAVE DUKE PËRFSHIRË EDHE KOMUNËN E FERIZAJT.

I

Me anë të këtij Vendimi Kuvendi i Komunës së Ferizajt shkëput apo tërheket nga marrëveshja me Agjensinë për Zhvillim Rajonal-Lindje “AZHR” e cila ishte lidhur me datë 16.12.2008 në mes të komunave duke e përfshirë edhe Komunën e Ferizajt.

II


Arsyeja e shkëputjes së këtij bashkëpunimi është që Komuna e Ferizajt ka bërë kërkesë për themelimin e një AZHR-je me seli në Ferizaj, e cila do të mbulonte regjionin e këtij qyteti.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm si dhe Kryetari i Komunës Ferizaj.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

 Xhavit Zariqi



 REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datede / Izdane / Datë / Data: 05.08.2025		
Nr. Orgv Org. jed: 01	Nr. Prot Br. Prot.: 76	Nr. Faqeve Br. Strana: 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.76
 Data: 31.07.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt me Nr.01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR MEMORANDUMIN E BASHKËPUNIMIT ME OJQ-TË, QENDRA PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE “SHTËPIA IME” – FERIZAJ

I

Me anë të këtij Vendimi miratohet nga Kuvendi i Komunës Memorandumi i bashkëpunimit OJQ-të, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Shtëpia Ime” – Ferizaj.

II

Memorandumi ka për qëllim krijimin e kushtëve për ofrimin e shërbimeve në trajtimin e grave dhe viktimave të dhunës në familje dhe rasteve të ngjajshme, shërbimi i cili do të ofrohet nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Shtëpia Ime” – Ferizaj nën monitorimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Komunës së Ferizajt.

III

Ky Memorandum lidhet në afat prej 10 viteve.

IV

Objekti për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e viktimave, caktohet vendi në Zaskok i ndërtuar në ngastrën kadastrale 638-0 Z.K. Zaskok, pronë e Komunës së Ferizajt. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Shtëpia Ime” – Ferizaj, shërbimin do ta ofroj pa pagesë, ndërsa buxhetin për aktivitete do ta sigurojë përmes donacioneve, do të sigurohet shfrytëzim efikas të fondeve të mbledhura për këtë projekt, si dhe do të raportojë donatorëve për aktivitete si dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale- QPS- së – Komuna e Ferizajt.

V

Monitorimi i këtij Memorandumi bëhet nga Drejtoria për Mirqenie Sociale dhe QPS Ferizaj.

VI

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirqenie Sociale të Komunës së Ferizajt.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izdavanje / Datum: 05.08.2025		
Nr. Orgv. Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot: 77	Nr. Faqeve. Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.77
Data: 31.07.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale me Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt me Nr.01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2025 miratoi këtë:

VENDIM
PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.109 I DATËS 30.09.2019
I PLOTËSUAR-NDRYSHUAR SIPAS VENDIMIT ME NR.01.NR.22 I DATËS
28.03.2025.

I

Me anë të këtij Vendimi plotësohet-ndryshohet Vendimi me Nr.01.Nr.109 i datës 30.09.2019 i plotësuar-ndryshuar me Vendimin me Nr. 01.Nr.22 i datës 28.03.2025, ndryshohet vetëm sa i përket afatit të pagesës së qirasë, ashtu që afati prej 3 viteve ndryshohet si në vijim: Komuna e Ferizajt Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës do t'i paguaj qiranë deri në përfundim të ndërtimit të objektit të Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të punës.

II

OBLIGOHET: Drejtoria e Financave që t'i paguaj të gjitha obligimet-qiratë e mbetura sipas Vendimit 01.Nr.109 të datës 30.09.2019 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.


III

Për realizimin e këtij Vendimi do të përkujdesen Drejtoria e Financave, Kuvendi dhe Kryetari i Komunës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 109
Datë: 30.09.2019

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) si dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, Qershor 2008), të nenit 11 paragrafi 1,2 dhe 4 të Ligjit nr.04/L-144, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, Dhjetor 2012), të nenit 10 paragrafit 1 dhe 25, paragrafi 2.11 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2019, miraton:

V E N D I M

PËR KËMBIMIN E NGASTRAVE KADASTRALE NR. 00707-2, 00708-2, 00707-1 ME NGASTRËN KADASTRALE 1749-6 Z.K. FERIZAJ

I

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pjesëve kadastrale të pronës së paluajtshme në pronësi të komunës me ngastrën kadastrale në pronësi të subjektit juridik, Organizata Komunale e Pensioneve dhe Invalidëve të Punës.

II

Sipas pikës I të këtij vendimi:

- Pjesa e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, ngastra kadastrale 00707-2, Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 600 m²;
- Pjesa e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, ngastra kadastrale 00708-2, Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 1000 m², dhe
- Pjesa e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, ngastra kadastrale 00707-1, Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 367 m², këmbëhet me:
Pjesën e pronës së paluajtshme në pronësi të subjektit juridik Organizata Komunale e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, ngastra kadastrale 1749-6, Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 1812 m².

III

Qëllimi i këmbimit të pronave të paluajtshme është krijimi i hapësirës për zgjerimin e rreth rrotullimit që lidhë rrugën "Epopeja e Jezercit", "Uran Tinova", "Dëshmorët e Kombit", ndërsa pjesa e mbetur e ngastrës kadastrale do të shërbej si park.

IV

Komuna e Ferizajt merr përsipër të paguaj shumat:
Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës shumën prej 1,535.00 €, në emër të hyrave që kanë realizuar nga qiratë e lokaleve afariste, deri në përfundim të ndërtimit të objektit, si dhe 550.00 € në emër të lokaleve të marrura me qira për byfe dhe zyre në kohëzgjatje prej 3

V

Këmbimi i cekur në pikën II të këtij vendimi, do të publikohet në veb faqen e komunës dhe tabelën e shpalljeve me të dhënat e pronave të këmbyera të paluajtshme dhe do të evidentohen në librat kadastral.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuese e Kuvendit të Komunës


Kristina Gashi Bytyçi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DIREKTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • DREKTORAT ADMINISTRATIVE LIGJIA

Datë: 05.08.2025

Nr. Org. 01 Nr. Prot. 78 Nr. Faqeve. 1
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.78
Data: 31.07.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2025 merre këtë:

VENDIM

**PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 20 I DATËS 30.01.2025 I
PLOTËSUAR – NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 57 TË DATËS 30.05.2025 PËR
PLOTËSIMIN E LISTËS REZERVË ME EMËRTIMET E RRUGËVE DHE SHESHEVE
PUBLIKE NË KOMUNËN E FERIZAJT.**

I

Me anë të këtij Vendimi Plotësohet - Ndryshohet Vendimi Nr.20 i datës 30.01.2025 i plotësuar – ndryshuar me Vendimin Nr.57 i datës 30.05.2025 për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt edhe me këta emra:

1	Parisi	Rrugë
2	Veteranët e UÇK-së	Rrugë
3	Shaip Munishi	Rrugë
4	Haxhi Nazifi	Rrugë
5	Kadri Paloja	Rrugë
6	Sabri Brahimi	Rrugë
7	Pajazit Qalaj	Rrugë
8	Zaim Delolli	Rrugë
9	Arif Rama	Rrugë

II

Për realizimin e këtij vendimi përkujdesen: Drejtoria për Urbanizëm si dhe Kuvendi i Komunës Ferizaj.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

